



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 51/3 prot.

Tiranë, më 12.03.2021

VENDIM
Nr.26, datë 12.03.2021

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 177, DATË 14.12.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 177, datë 14.12.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 30969, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 775 prot., datë 7.10.2020, nëpunësi doganor ***** ka parashtruar pretendimin se transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin “Doganier, Zyra e Kontrolleve Doganore”, Sektori i Mbikëqyrjes Doganore, Dega Doganore Fier, është bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil që rregullojnë transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të gjithë materialin shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera për transferimin e këtij nëpunësi.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin nr.177, datë 14.12.2020, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 30969, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka informuar Komisionerin me shkresën nr. 3703/1 prot., datë 01.3.2021, *“Kthim përgjigje”*, në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur një pjesë të dokumentacionit. Gjithashtu, njësia përgjegjëse, në rrugë elektronike, në datën 3 mars 2021, ka dërguar pjesën e dokumentacionit që mungonte në shkresën e sipërpërmendur dhe që vërteton zbatimin e plotë të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 177, datë 14.12.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i hetimit administrativ paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të nxjerrë aktin përkatës administrativ për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës *“Doganier”*, Sektori i Vlerës në Qendër, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar dhe mungon pëlqimi i nëpunësit për të vazhduar në atë pozicion pune.

Konstatova se, nga ana e institucionit janë marrë masa për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë, duke e kthyer nëpunësin në pozicionin e mëparshëm. Konkretisht, me Urdhrin nr. 3703 prot., datë 24.2.2021, *“Për rikthim në detyrën e mëparshme”*, nëpunësi ***** është rikthyer në pozicionin *“Doganier”*, Sektori i Vlerës në Qendër, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 177, datë 14.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 30969, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 177, datë 14.12.2020.

3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësi
*****.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha